

# KPK konfirmon në detyrë gjyqtaren që liroi Lulzim Berishën

Nga [Exit News](#) 20 orë më parë



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi në detyrë, ditën e martë, më 4 gusht, gjyqtaren e Gjykatës së Apelit të Durrësit, Anita Mici, e njohur për lirimin nga burgu të anëtarit të bandës së Durrësit Lulzim Berisha. Trupa gjykuese përbëhej nga gjyqtarët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici.

KPK nuk gjeti probleme e pasurinë e gjyqtares si dhe hodhi poshtë një raport me papërshtatshmëri nga DSIK. Ndërsa, Komisioni dërgoi për inspektim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çështjen e lirimit të Lulzim Berishës. Me një vendim të dyshimtë gjykate, Anita Mici liroi në 2016 Lulzim Berishën, me justifikimin se ai kishte siguruar një kontratë punë në Bashkinë Durrës.

Anita Mici ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002-2005 dhe është emëruar fillimisht gjyqtare në Gjykatën e Shkodrës. Në vitin 2010, Mici u transferua në Gjykatën e Durrësit ndërsa në vitin 2016 u dekretua gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës.